



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.7/22

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, kryetarja e gjykatës, Shpresa Emra, duke vepruar sipas Ankesës së palës D.Q., nga Prizreni parashtruar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës kundër gjyqtarit A.S., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit të lartcekur në bazë të së cilës është bërë iniciimi i procedurës disiplinore, me **datë 25.08.2022, mori këtë:**

### AKTVENDIM

Refuzohen si të pabazuara deklaratimet e D.Q. nga Prizreni, ndaj gjyqtarit të kësaj Gjykate, A.S., për iniciimin e procedurës disiplinore.

#### Arsyetim

Parashtruesi i ankesës D.Q., nga Prizreni është ankuar se gjyqtari A.S., duke përdorur pozitën e tij për të frikësuar dhe shantazhuar në baza etnike ka kërcënuar fqinjin e tij. Ai ka cekur se me rastin e fillimit të renovimit të shtëpisë së tij ka gjetur se fqinji respektivisht gjyshi i gjyqtarit A.S., ka uzurpuar disa metra nga prona e tij. Këtë i ka treguar gjyqtarit A. dhe familjarëve të tij dhe që nga ajo kohë ka kërcënime nga familja e tij dhe personalisht nga vet gjyqtari. Konkretisht me dt. 20 07.2022 ka ndodhur një rast ku ne ata kanë pasur një aheng dhe kah ora 11.00 të ditës ka ardhur gjyqtari A. te dera e shtëpisë së tyre dhe ka kërcënuar se një kameran e ka parkuar veturën në parkingun para shtëpisë së tij( para marketit ".....") duke thënë se askush nuk mundet të parkojë veturën para shtëpisë së tij dhe aq më pak ata mund të parkojnë, dhe i ka fyer në baza etnike(magjup). Aty pari ka kaluar një police që nuk ishte në detyrë dhe gjyqtari ka tentuar që ti arrestojë vetëm pse kërkonim të dinin arsyen për kërcënim. Sipas deklaratës kjo nuk është hera e pare që sulmohen dhe kërcënohen dhe se gjyqtari A. e përdor pozitën e tij për të frikësuar dhe kërcënuar.

Si Kryetare e Gjykatës ankesën e kam pranuar nga Këshilli gjyqësor dhe pas pranimit të ankesës kam kërkuar që gjyqtari A.S., të deklarohet. I njëjti ka cekur se është e vërtetë se ka ndodhur një rast ku një veturë është parkuar para shtëpisë së tij , respektivisht para shitores së "....." e cila është e vendosur në përdhesen e shtëpisë së tij, ku ka ardhur kamioni për furnizim me madh të marketit dhe nuk kanë mundur të parkohen dhe të shkarkojnë mallin. Kanë ardhur tek ai si pronar dhe e kanë pyetur se i kujt është automjeti i parkuar sepse po pengon vend parkimin e marketit. Ai është interesuar për pronarin e automjetit dhe një komshi i ka thënë se mund të jetë ndonjë person që ka ardhur tek komshiu D.Q., dhe ka shkuar dhe e ka thirrur të njëjtin. Personi i cili e kishte parkuar veturën ka ardhur dhe Gjyqtari nuk e ka njohur por i ka thënë se se nuk duhet të parkoni veturën para vend parkimit te rezervuar të marketit ".... ". Mbas këtyre fjalëve ai person i është drejtuar me fjalë " a e din se kush jam unë" dhe gjyqtari ka thënë se nuk e din dhe se duhet të largon automjeti, atëherë komshiu D.Q., i është afruar dhe i ka thënë " ke me mar vesh se kush

jam unë dhe pa të ndërrua pozitën e punës nuk kam me të lënë". Ka cekur se nuk qëndrojnë pretendimet se e ka kanosur dhe ka kërcënuar ose shantazhuar komshiun ose se ka bërë pretendime për largimin e tij nga aty, ata jetojnë me vite aty dhe nuk kanë pasur mosmarrëveshje me ta kurrë më pare jo me ata, por me askënd në lagje.

Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka inicuar hetimet për procedure disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shqimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes ka verifikuar nëse ka ndonjë rast të inicuar ndaj gjyqtarit për kanosje dhe nëse janë kryer të gjitha veprimet adekuate për vazhdim të procedurës sipas ankesë. Pasi ka analizuar pretendimet ankimore, ka konstatuar se:

**Ankesa është e pabazuar.**


Është vlerësim te kryetarja e gjykatës se në rastin konkret gjyqtarit ka kryer disa veprime si person privat dhe jo në kuadër të kompetencave si gjyqtar. Me komshiun nuk ka pasur ndonjë lëndë në gjykatë për të cilën do të ishte lidhur rasti konkret, nuk ka pasur ndonjë lajmërim në polici ose inicim të rastit për kanosje, frikësim ose shantazh në baza etnike të evidentuar.

Kryetarja ka vlerësuar se në rastin konkretë nuk ka pasur bazë për shkelje disiplinore në rastin konkret pasi që nuk ka prova se rasti është lajmëruar dhe është inicuar ndonjë procedure ligjore ndaj gjyqtarit në polici, prokurori ose gjykatë që do të vërtetonte dhe plotësonte pretendimet e ankuesit në këtë rast respektivisht nuk janë përmbushur dispozitat nga shkeljet disiplinore për gjyqtarë të paraparë nga neni 5 i Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve nr. 06/L-067.

Për arsyet që u cekura më lartë, është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**AD-GJTHPZ.nr.7/22 me dt. 25.08.2022**

**Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren**



**KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e paraparë e drejta e ankesës.**